



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Euro Construction” të datës 30.01.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 25.01.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i objektit të arkivës së komunës me infrastrukturë përcjellëse” me nr. të prokurimit 616-23-12502-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Euro Construction” e datës 30.01.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 25.01.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i objektit të arkivës së komunës me infrastrukturë përcjellëse” me nr. të prokurimit 616-23-12502-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “Euro Construction” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Euro Construction” (tutje “parashtruesi”) me datë 30.01.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 25.01.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i objektit të arkivës së komunës me infrastrukturë përcjellëse” me nr. të prokurimit 616-23-12502-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Ju sqarojmë se autoriteti kontraktues ka rekomanduar për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm për faktet si në vijim:

Ne dosjen e tenderit tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale tek neni 9.1.&0.2 i FDT-se përkatësisht tek kërkesa nr.3 është kërkuar: **3. - Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit. Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT.**

Numri i Prokurimit 616 23 12502 521 – Titulli Ndërbimi i objektivit të arhivës së komunës me infrastrukturë përcjellëse

Aneksi 7 LISTA E PAJISJEVE

MJETET E PUNËS

Nr.	Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve	Sasia e kërkuar (cope)	Të dhënat për pajisjet
			(viti i prodhimit, gjendja e pajisjes, kamiona rexh. i targave, mekanizimi, dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim foto etj)
1	Kamion me kran dhe kiper me peshe bartëse minimum 2 ton	1	
2	Kamion vetëshkarkues min 10 m ³	1	
3	Ekskavator	1	

Vrejtje: OE duhet ta plotësoj kolonën D me të gjitha të dhënat për pajisjet e ofruara siç është (viti i prodhimit, gjendja e pajisjes, kamiona rexhistrimi i i targave, mekanizimi, dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim, foto etj)

OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar kërkesën e lartcekur për faktin se në ofertën e tij i njëjti ka prezantuar kamion me kran i cili nuk është sipas kërkesës së lartcekur, ku është specifikuar

tek pika 1: kamion me kran dhe kiper.

Faktin se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar kërkesën e lartcekur, e ka vërtetuar vet autoriteti kontraktues në vendimin e saj për aprovimin e kërkesës tonë për rishqyrtim të dt.04.01.2024, ku i njëjti e kishte aprovuar si të bazuar pretendimin tonë ankimor sa i përket pajisjes së kontestuar më lartë nga ana jonë.

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet cekur se përmes aneksit 7 të dosjes së tenderit është kërkuar ndër të tjera edhe një "Kamion me kran dhe kiper dhe peshe bartëse minimum 2 ton".

Aneksi 7 LISTA E PAJISJEVE

MJETET E PUNËS |

Nr.	Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve	Sasia e kërkuar (cope)	Të dhënat për pajisjet (viti i prodhimit ,gjendja e pajisjes , kamiona rexh. I targave, mekanizimi , dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim foto etj)
1	Kamion me kran dhe kiper me peshe bartëse minimum 2 ton	1	
2	Kamion vetëshkarkues min 10 m ³	1	
3	Ekskavator	1	

Vrejtje: OE duhet ta plotësoj kolonën D me te gjitha te dhënat për pajisjet e ofruara siç është (viti i prodhimit , gjendja e pajisjes , kamiona rexhistrimi i I targave, mekanizimi , dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim , foto etj)

Sa i përket pretendimeve ankimore kundër tenderuesit të rekomanduar është gjetur se me datë 10.01.2024 komisioni vlerësues ka kërkuar sqarime shtesë pikërisht lidhur me përmbushjen e kërkesave sipas aneksit 7 të dosjes së tenderit. Me datë 12.01.2024 tenderuesi i rekomanduar ka dërguar sqarimet e kërkuara si në vijim:

Në emër të “PROTEC” sh.p.k. nga Prizreni me Nr.Biznesi 810045874, prodhues dhe montues i certifikuar i Sistemeve Modulare për Ruajtjen e Dokumenteve Arkivore, deklarojmë se, në aktivitetin e prokurimit me titull “*Ndertimi i objektivit te Arhives se Komunes me infrastrukture percjellese*” me numër të prokurimit: **616-23-12502-5-2-1** me Autoritetin kontraktues- “**KOMUNA E PRISHTINËS**” jemi duke marrë pjesë vetëm në Grupin e Operatorëve Ekonomik: MBB Construction dhe SH.P.K. dhe PROTEC SH.P.K. dhe se nuk jemi pjesë e asnjë grupi tjetër që merr pjesë ne procedurë të njejtë të prokurimit.

Deklarojmë se, asnjë Operator Ekonomik apo Grup i Operatorëve Ekonomik (përpos Grupit të Operatorëve Ekonomik: MBB Construction dhe SH.P.K. dhe PROTEC SH.P.K.) **nuk është i Autorizuar** ta dorëzojë katalogun e prodhimeve tona, në procedurën e prokurimit me titull: “*Ndertimi i objektivit te Arhives se Komunes me infrastrukture percjellese*” me numër të prokurimit: **616-23-12502-5-2-1**.

Përdorimi i katalogut tonë nga cilido Operator Ekonomik apo Grup i Operatorëve Ekonomik, (pos Grupit të Operatorëve Ekonomik: MBB Construction dhe SH.P.K. dhe PROTEC SH.P.K.) në këtë aktivitet të prokurimit, është **i pa autorizuar** dhe është **keqpërdorim**.

Duhet cekur poashtu se asnjë kompani apo individ, nuk është i autorizuar të bëjë montimin e Sistemeve Modulare për Ruajtjen e Dokumenteve Arkivore të prodhuara nga “PROTEC” SH.P.K. përpos monterëve të certifikuar të kompanisë PROTEC SH.P.K.

Komisioni vlerësues i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga tenderuesi i rekomanduar. Për më tepër në raportin e komisionit vlerësues është evidentuar si vijon:

Vërejtje përmblylëse në lidhje me vlerësimin e tenderëve të përgjegjshëm:

Komisioni i vlerësimit konstatoi se gjithsej për këto tender ofertat e tyre i kanë dorëzuar pesë operator ekonomik. Kater prej tyre janë të papërgjegjshëm dhe një prej tyre është i përgjegjshëm.
OE - Olti Trasing SH.P.K., katalogu i ofruar nuk përmbush kërkesat e specifikimit teknik të kërkuara nga AK.

Grup i Operatorëve Ekonomik Global Holding SH.P.K.; NIKA PrO- Ing SH.P.K nuk ka ofruar atalogun e kërkuar sipas kërkesave të kërkuara në njoftimin për kontratë dhe në Dosjen e Tenderit

Grup i Operatorëve Ekonomik AKTIV SH.P.K.; Ari House SH.P.K. katalogu i ofruar nuk përmbush kërkesat e specifikimit teknik të kërkuara nga AK.

Grup i Operatorëve Ekonomik AKTIV SH.P.K.; Art House SH.P.K. nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e kërkuara në Njoftimin për kontratë dhe në Dosjen etenderit, katalogu i ofruar nuk përmbush kërkesat e specifikimit teknik të kërkuara nga AK.

Grup i Operatorëve Ekonomik N.N.P. EURO CONSTRUCTION ; SINANI - ING SH.P.K.; TIC LOG SH.P.K. nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e kërkuara në Njoftimin për kontratë dhe në Dosjen e tenderit, katalogu i ofruar nuk është në pajtim me OE Protec Shpk i cili pas sqarimeve të kërkuara nga ana e AK deklaroi se: Asnjë Operator Ekonomik apo grup i Operatoreve Ekonomik (përpos Grupit të Operatoreve Ekonomik: MBB Construction dhe Protec Shpk) nuk është i autorizuar ta dorëzojë katalogun e prodhimeve tona në procedurën e prokurimit me titull: ndërtimi i objektit të Arhivës së Komunes me infrastrukture përcjellëse me numër të prokurimit: 616 23 12502 521. Përdorimi i katalogut tone nga cilido Operator Ekonomik apo grup i Operatoreve Ekonomik përpos grupit të operatoreve Ekonomik MBB Construction dhe Protec Shpk në këto aktivitete të prokurimit është i paautorizuar dhe është keqpërdorim.

Grup i Operatorëve Ekonomik MBB Construction SH.P.K.; PROTEC SH.P.K. i ka plotësuar të gjitha kërkesat e kërkuara në Njoftimin për kontratë dhe në Dosjen e Tenderit.

Komisioni për vlerësimin e ofertave vendosi që me kontratë për ndërtimin e objektit të Arhivës së Komunes me infrastrukture përcjellëse ta propozoi Grupin e Operatorëve Ekonomik MBB Construction SH.P.K.; PROTEC SH.P.K. me vlerë të ofertes prej: 288,385.00 euro.

Duhet cekur se parashtruesi është eliminuar si tenderues i papërgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit për shkak të arsyeve të evidentuara në letrën standarde si vijon:

ARSYETIM

Nuk keni ofruar katalogun e kërkuar sipas pikës 7 në kërkesat teknike dhe profesionale pika 9.1&9.2 Në Njoftimin për kontratë dhe në Dosjen e Tenderit pika 9.1&9.2 në pikën 7 është kërkuar:
OE duhet të ofroj katalogun që përmbush specifikimin teknik.

Dëshmia:

Kopja e Katalogut nga prodhuesi apo distributori. Ju nuk keni ofruar katalog si qeshte kërkuar në Njoftimin për kontratë dhe në Dosjen e Tenderit.

Ju keni ofruar katalogun që është nga operatori Protec Shpk i cili operator është në marrëveshje bashkëpunimi me operatorin MBB Construction dhe i cili pas sqarimeve të kërkuara nga ana e AK është deklaruar se: Asnjë Operator Ekonomik apo grup i Operatoreve Ekonomik (përpos Grupit të Operatoreve Ekonomik: MBB Construction dhe Protec Shpk) nuk është i autorizuar ta dorëzojë katalogun e prodhimeve tona në procedurën e prokurimit me titull: ndërtimi i objektit të Arshivës së Komunës me infrastrukture përcjellëse me numër të prokurimit: 616 23 12502 521. Përdorimi i katalogut tone nga cilido Operator Ekonomik apo grup i Operatoreve Ekonomik përpos grupit të operatoreve Ekonomik MBB Construction dhe Protec Shpk në këtë aktivitet të prokurimit është i paautorizuar dhe është keqpërdorim.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimi i parashtruesit është tërësisht i pabazuar. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 31.01.2024



Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.